Ilir F.Çabrati

Jeton në mua

(POEZI)

Përjetësisht prindërve të mi.

Redaktore
Shqiponjë Axhami,prof.

Meditimin
Shqiponjë Axhami,prof.

Ballina
Flamur Salihi, stud.

Ilir F.Çabrati

Jeton në mua

Mars, 2012

Poetët nuk lindin po edhe nëse lindin janë poet të nemur, poetët krijohen nga të bëmat e shoqërisë.

(autori)

"Dua ta drejtoj krijimtarinë
ty që pa qenë dashtë të
humbë e për hirë të
dashurisë së sinqertë vuaj
të bëmat e tua"

Meditim

Kur lexova në fillim poezitë e **ILIRIT** të them të drejtën ndryshe nga shumë të tjerë me mahniti, kjo për faktin që këtu në mënyrë definitive ka diçka ndryshe, falë shumë komponentëve poezia e tij vjen stërhollo ndryshe në tematikë, në formë dhe ne përmbajtje.
Duke u ndalur tek e para vihet re një tematike e shumëllojshme qe orvatet te gjej skutat më të errtë të nënndërgjegjes ankthet e saj kjo në shumë parametra që nga dashuria deri te vetgjygjsia, por jo vetëm kjo Iliri edhe kur shkruan për një tematikë të thjesht ka elementin tipik **ILIRIAN** brenda .
Për sa i përket formës edhe këtu poeti ka menduar nj stil ndryshe një varg të çrregullt jo të renditur ndoshta si vetë shpërthimet e tij, figura është e pranishme por ajo vjen tërthorazi pikërisht ngjyer në këtë stil.
Përmbajtja lë për të dëshiruar, aty humbet në një patos që është vështirë ta kuptosh më një të lexuar.
Në këto poezi ose në shumicën prej tyre shef fluturimin e poetit në botën tjetër, a nuk është në fund të fundit enigma më e madhe kjo, për të gjithë ne se çndodh atje duke u ndalur më shumë tek kjo doja të them që në këtë aspekt Iliri bën një prerje të mahnitshme filozofike të këtyre dy botve, personazhet atje duket sikur luajnë lojën e realitetit këtu, dhe aq në detaje e jap ai këtë sa të duket sikur po lexon **DANTEN** e madh, unë personalisht kam mbetur pa fjalë nga ky stil krejt i veçantë i tij dhe e përgëzoj në vazhdimësi që të ketë edhe më shumë suksese. Ilir po të shkruaj këtë citat nga unë. Njerëzit që rreken të trokasin në dyert e botës tjetër kërkojnë pavdekësinë, a nuk është kjo enigma që na shqetëson.

Shqiponja Axhami,prof.

Jeton në mua

Një frikë dhe një pulsim zemre më **përshkoj** një ndjenjë skeptike në mendje rrinte një ikje një pëshpëritje zëri u **dëgjua** nga errësira jeton në mua një vegim përshkrimi fizikë një trokitje pran portës një hapje e shpejt, por vetëm errësirë dhe jo më shumë zë drithërues e shumë rrëqethës që vinte nga errësira një tingëllim e fuqishme jeton në mua e dija thash me vete është **Nosida** fola me një gjysmë zëri të shterur eja futu Nosida ime e magjepsur te kam mbuluar në petkun tim nuk do të lëshoj jam futur në aromën tënde që lëshon në ajrin e ngjyrosur me aromë dashurie jam kapur me **aromën** e duarve të tua që çdo ditë të shtrëngoj e s'mundem të them fjalën më të lehtë më lër thellësisht të fus kokën e pafundësisht të **absorboj** aromën e flokëve të tua ah sikur të mundë ti demonstroja të gjitha ato që ndjejë që unë shoh e dëgjoj në ty shpirti im **lundron** mbi nostalgjinë tënde sikur shpirti i filozofëve nëpër teoritë e pashtershme të antikitetit mes dhomës të mbuluar me mure thith vetëm aromën e librave të vjetruara e të metura në kohë e nga kujtesa për shumë çaste me humbasësh ti kjo **dozë** opiumi gjithmonë më ndjek nga pas.

Lidhmëni me E.....

Idhull e **idil** e bukura shkronja E..... kaskat në mbrojtje nga vërshimet pikante.
Kapërtypje nga goja një skuqje në tingëllim harmoni ndjenjash që lidhin epshin tim.
E..... ja ndër të parat që **vargon** nga etrit e përfundon në fiksim.
Është fikse nga të tjerët se tregon një kuptim nuk është **monotone** se ajo ka një takim.
Kulmohet qëndron lart nga shkronjat e tjera gjentile elegante shumë mirë të rrinë në brez.
Gjithçka është kjo E..... turbulencë në njerëz mistike është me shumë se mike.
Potenciali saj nuk **matet** me kile se ajo peshon me opium diturie.
Udhëton nder rrugica pa humbur shumë kohë nuk jepet me njerëz që të ketë dro.
Që të gjithë tek E..... shumë të përqendruar a thua do të ketë fjalë atë për ta përshkruar.
I tharë në mes dy qirinjve duke shkruar në jetë vetëm këta njerëz të jenë të vërtet të tretesh për ta është gjithmonë hyjnore por të mbetesh në të si rreze **diellore**.
Hiperbola saj nuk është imagjinare se ajo gjëmon mbi etjen familjare.

Pranë librave

I katandisur mbes nga mjegulla e
diturisë që tentoj të bëj **koncepte**.
I ndarë përjetësisht nga dita i futur
përjetësisht në brigjet e
pafundshme të natës.
Një konvertim në vet nga e
mundshmja në libër një ardhmëri
e ndritur nga ajo përsëri një
micingrisje në nerva për
të një ankth frike duke u përsëritur
nga ajo por përsëri
një krenari të një të dituri.

Kangjele

Mbi kangjelen e **lethitur** rri i strukur i mërzitur
vuaj pa pushim e pres ndër pozoja se hyn
përsëri një trokitje e hap derën po s'sho gjë.
Eja futu ti errësirë të marrësh mua pa mëshirë
dhe ta lësh atë të lirë.
Ç'është ky trup i përsosur e i shkathët i
përlloqur. Ç'është kjo vuajtje që s'më hiqet mbi
sytë e tu të joshitur.
Ç'është kjo hije e zezë e errët që rri strukur mbi
atë derë ngrihem shpejt brof në këmbë hapi
derën po s'shoh gjë është errësira që **ngulfat**
epshin tim për një dëshirë.
E kështu netë për netë e natë për natë e pres
zonjën që të hyj, por ky thjesht është
mallëngjim që më humbet në kujtim.

Pasioni

Jam i strukur në errësirë **godas** penën pa mëshirë.
Ky shikim lidhatak më shtrëngon mua aq pak duket fort se është i pakt kam dëshirë të përqafoj puthjen time në kockë ta qoj po ta shprehi dashurinë vuaj unë ta shprehish ti .
Ç'është fytyra e **joshitur** që më len të habitur ?
Ç'janë kto buzë të pikturuara është koha për ti shijuar ?
Ç'janë këta sy të joshitur brenda të bukur e të qëndisur?
Ç'është ky trup i bukur i hollë a thua brenda do të ketë njollë?
Ç'janë këto duar të **lezetshme** brenda n'shpirt janë të prekshme?
Ç'është ky mall imagjinar që më sillet rreth vërdallë.

Korbi

Përmbi bjeshkët e thepisura qëndron fshati i mërtisur e i veshur i **zbukuruar** plot me druajë i praruar.
E mbi bjeshkët e thepisura krahëmor shkon një korb është i errët shumë i zi vetëtimë shkon mbi shtëpi struket shpejt në havlli godet zërin si burri sè dëgjon kush e bën mahi ik me vrap o korbi zi sa **s'godita** ty në bri.
Zmadhon krahët për mrekulli shkon skifter për mbi shtëpi e shkon futet në pyll të zi.

Ferri

Mbi pllaka të ferrit trokasin mijëra shpirtra të daktisur e të frustruar nga ajo që kanë bërë.
Mbi pllaka të **pluhnosura** dëgjohen ulërima e klithma që shtrëngohen e shtrëngohen po pa rezultate.
Mbi ato pllaka të pluhnosura me emra të shlyera trokasin e **trokasin** pa pushim.
Një erë e errët që i ngulfat shpirtrat e tyre pa pushim.
E tendosja thellohet deri në mallëngjim.
Ku nga frika kërkojnë shpëtim por kërkimi për shpëtim humbet shpejt në mallëngjim.
E prej vuajtjeve vrazhdë shkojnë shpirtrat si të pa mbrojtur nga mëkatet e nga lustrat e tyre të ndyra rrinë të strukur e nuk flasin mbi **censurën** që i bëhet.
Ashtu shikoj dallgë mbi dallgë e mbi humnerë humben shpirtrat në errrësirë e nga pluhuri që i planos humben shpejt si një njollë.

Ty Faik

Të kam në duar o zogu im nuk të lëshoj kurrë edhe ti pse ike pa më thënë asnjë fjalë.
Të shoh çdo ditë në ëndërr i veshur me petkun e zi që rri i strukur pranë një **qyshe** të vogël e të errët vi që të përqafoj po më humbësh pranë syve dhe urrejtja mi micingris nervat sa që dua ta shqyej mallëngjimin.
O Faik të kujtoj unë nëna jote që kur bie në shtrat për ta pushuar trupin mendja nuk më hiqet nga ti.
Ti kujtoj ca momente të fëmijëris jo të hareshme por të ngulfatur nga skamja e të **torturuar** nga të tjerët.
Jam unë nëna jote që mu shterën sytë duke qarë.
Por një ditë jam e sigurt që edhe këto vite të shkurtra të pleqërisë që më kanë mbetur do të vi dhe do të takoj pran **varreve** të shkreta e do të përqafoj e do të ledhatoj aq fortë sa që edhe të tjerët do të kanë lakmi.
Po të kujtoj vetëm unë nëna jote .
Po më duket se kam mbetur e vetme në këtë botë e të tjerët të kanë harruar **o biri im**.
Jam lodhur e rraskapitur fort nga mërzia o biri im dua të sakrifikoj. Çdo gjë për ty e vetëm të puthi dorën e të ulem pranë njërit tjetrit e të flasim për të kaluarën e errët që ta grabiti jetën e s'të la që edhe ti të jesh pranë mesit tonë dhe të jetosh si të tjerët.
O biri im më dridhet zëri kur e kujtoj të kalurën tënde heroike dhe disi përsëri marr ndjenjën e forcës për të jetuar e të kujtuar ty.

O biri im të jesh i sigurt se çdo mëngjes shkoj
për ta vizituar varrin tënd e për të **përqafuar** së
paku fotografin tënde që ka mbetur e vetme po
them e vetme edhe pse ka shumë shokë por
pran varrit tënd kanë çelur ca **trëndafila** që unë
me kujdes shkoj për ti ujitur.
Se këtu kur të bie dielli do të bëj hije. Mbi
trupin tënd kam mbjellur ca lule
me aromë të bukur sa që kur të kalojnë
udhëtarët të kthejnë kokën dhe të kujojn ty o
biri im.
Ti kujtoj vitet që po të ecin në këto anë po
bëhen dasma po martohen miqtë e tu o **idhulli**
im sikur të kisha pranë do të të zgjidhja një nga
vashat më të bukura që ka fshati e do të bëja
dasmë të madhe por mos ki frik se do të martoj
se pran varrit do ta bi një **duvak** të bukur e me
petkun e kuq që do të shoqëron vite e vite me
radhë.
Tani biri im fli i qet pran hijeve të lisave e pran
miqve e shokëve të tu mos u ndajë do ta japë
fjalën që çdo hap më ke mbrapa dhe s'do të
harroj kurrë sa do të jem në këtë **botë** të

shkurtër por me vlera të mëdha edhe pse e shijova pa ty biri im.
Jo s'dua të them lamtumirë përmes kësaj letre të shkurtër dua të mbaj në zemër **përgjithmonë** sa të jetë jeta për të jetuar e mallëngjimin që kam për ty të mos vdes kurrë e të **mbetet pezull** përgjithmonë.

Mon Karavidaj

Jam hipnotizuar pranë **fotografisë** tënde që si
një yll po shkëlqen në mes të dhomës.
Jam ndjerë krenar tek babai yt që thurte vargje
për trimërinë tënde.
Ndihem shumë fajtor që nuk pata rastin të të
njohë, por ja që koha ma mohoj një gjë të tillë e
të shkëmbej fraza të bukura të **lirisë** që misioni
yt ishte si misioni i kalitur me shkronja të arta
që në të mos jetojmë me petkun e **gjakpirësit**
të armikut që zhvillonte luftën ndërmjet tyre e
fëmijëve. Miku im i dashur ti je më shumë se
një hyjni për ne që jemi në tokë. Sakrifica jote
ndahet me etërit që varrosnin bijtë e tyre.
A miku im më kujtohen fjalët e të atit që
rrëfente për guximin e antikitetin e nocioneve të
çmuar të **UÇK–së**.
Ti je arkitekt me i madh i lirisë që sot e
absorbojmë. Jetojmë pranë sakrificave tuaja,
jetojmë pranë imagjinatës që një ditë të vish
edhe ti e të na bësh vizita të paparalajmëruara.
Përuljën pranë teje e ndjenje të **privilegjuar** për
ty o njeriu im pa emër, por me punë të mëdha e
shumë titanike.

Të Pres

Do lagem në shiun që po bjerë **rrëmbishëm** mbi mua .
Po ngulfatëm nga mjegulla e errët që ta ka mbuluar petkun tënd të bukur e që po të shkëlqen edhe në këto ditë me shi.
S'dua të ndaj shikimin nga ti edhe pse koha po ecën dua të ndaloj çdo gjë në **botë** vetëm që të shikoj.
Po të presë edhe në këto ditë me shi e me mjegull.
Mbi shtëpinë tënde buron **kroi** me ujë të kulluar, po them të kulluar ashtu si bukuria jote që po shndritë buzët e kroit e unë spo ndaj shikimin nga ti.
Ende pa zbardhur drita pran kroit tënd bukurosh vi për ta shikuar **shtatin** tënd të bukur që çdo mëngjes vjen për të mbushur ujë e unë nga bukuria jote mbes i ngrirë dhe i pa fjalë.
Kam filluar ta dashuroj edhe fshatin sidomos shtëpinë tënde që gjendet buzë pyllit që po shkëlqen mbi të gjitha .
S'dua t'i heq sytë nga dritarja jote me korniza të vogla e të zbukuruar që del e vendos pëllëmbët e duarve mbi të e me sytë e saj të mbushur plot me dashuri lëshon poshtë në lendinë aty ku jam unë.
E unë **digjem nga zjarri** yt që po lëshohet mbi mua.

Nena ime

Po ja filloj me fjalët më **piklluse** e më rënduese që kam pasur ndonjherë në jetë.
Po ti kujtoj vitet e shkurta që kaluam bashkë e prej mallëngjimit që kam dua që të shoh njëherë e të ledhatoj fort.Por i vetmi kujtim më i freskët për mua është ai kur ta vizitoj **varrin** tënd. Aty mbushem me kujtime të freskëta e shumë rënduese për mua .Nena ime e vjetër, po them e vjetër ndoshta ka kaluar një periudhë kohore sepse ende je me ne dhe e **freskët** je në kujtesën tonë.
E sot pikërisht kam ardhur ta vizitoj varrin tënd pran kafkës tënde jam ulur dhe po më rrjedhin lotët pa pushim po them me një gjysmë zëri që ti të më dëgjosh e së paku të më kthesh përgjigjet e pyetjeve që do ti bëj.
Jam i etur që ta shoh fytyrën tënde besoj se dheu i pa mëshirshëm që të ka rën nuk ta ka **kalbur** fytyrën tënde të ndritur e të zbukuruar.
Ah nena ime e vjetër! E di se je duke më dëgjuar, por është e kot të kthesh përgjigjeje sepse era dhe llava e zezë po ti dëbon fjalët dhe po ti hedhë në një pafundësi.Po shoh se në qiellin e pa kufishëm dielli ka lëshuar rrezet

pikërisht mbi mua e dija se ai është **shikimi yt,**
nena ime e dashur.
Më falë që ta rëndova shpirtin tënd të butë e
shumë lidhatak ndjenjat dhe dëshirat më bëjnë
që të veproj kështu .
Tani nena ime e vjetër fli e qet, era dhe vrulli i
zi ty nuk do të lëkund aspak je e vetmja nënë që
të njoha si besnike të dashur e të pa harruar nga
ana ime**…..**

Poeti

Mbi divanin tënd të **plunosur** sillesh e ngrihesh
pa kufi.
Mbi ambicien tënde të madhe të shkruash
rreshta pa kufi.
Ti poet je i prekshëm gjerë **në mëkat** i pa zënë
as një natë .

Bukur shkronjat i ledhaton sepse punën shumë
e donë.
Bukur temat i trajton edhe vitet shpejt i kalon.
Pena jote rënd peshon edhe cakut ja qëllon.
Prej së lartit na sheh neve dhe fragmente,
ti na bën je i pa zëvendësueshëm dhe shumë
pak i kërkueshëm.
Fytyra jote shumë e **vrazhdë** sepse vite kalon
në stazh.
Je i mbyllur shumë në lustra pak i njohur për të
tjerët.
Sepse hallet e të tjerëve me **gjuhë të zemrës** i
shpjegon.

Ju porosis

Që kur të vdes mos bëni mëkat të më qani ju
lutëm që mbi mua të **hidhet balta** e ndyrë dhe
mbi baltë të mbizotrojn shkrimet gjurmë
gjurmë mos i thuani askujt për vdekjen time
heshtja të mbizotëroj.
Gjurmët të fillojnë të bëjnë ecjet e tyre mbi
pyllin pa zhurmë dhe t'u bin kronika të
vazhdueshme mbi të **andejshmen** që po ndodhë
e të mos ndihen gjurmët nëpër pyll fare.
Mbi **gurin** e varrë të shënohet freskët emri im
në mënyrë të kujtona për shumë vit.
Ndër hije të lisave do fle i qetë dhe mbi vizitën
e juaj dotë pushoj rehat.

Unë dhe nata

Po sfidoj natën atë që pak po e njoh.
Filloj ta **dashuroj** natën ajo pak më donë.
Po flas me të fare s'më dëgjon.
Po i them që të flet e së paku të më thotë që të mos jetoi kot ose të më tregon historinë e jetës sime që të mos mbes kështu në **kujtime** që ta di a të rroj a te mos rroj.
Po flas me sendet aty që spo i shoh po mua më thonë se aty janë.
Nuk dua të flas me këtë errësirë që ta **ngulfat** shpirtin e s'të lë të lirë.

T r e n c i n a

Ndërtove komedinë si poemë epike! ja bëre bazë strukturën mistike
Fillove nga **ferri** lulëzove parajsën.
E le mu në mes **purgatorin** virtytin pasuror.
Purgatori yt i ëmbël është Dante.
Ferri yt i pa mëshirshëm është Dante.
Parajsa jote është shumë magjepse është e larmishme shumë e pa arritshme.
Vegimi yt po na ringjall ndjenja po na shtohet jeta edhe intuita po na ngrenë nga shtrati na fut

në mendime se bota e **andejshme** është për kërkime.
Kangjelet e ferrit po na fusin në mendime e ato të parajsës na futin **nëmallëngjime**.
Vegimi yt shumë imagjinar fillove me Virgjilin princin legjendar ti tregoj fshhetsitë e jetës mëkatare .
Fillove me të bukurën
Beatriqën vajzë që **simbolizon** dashurin dhe bukurin faktike përcjellësja e parajsës dhe e të bukurës botë.
O i madhi **Dante** ti i le pa fjalë mijra kundërshtar.
Fillove me vite fare pa u ndal ja bëre popullit gjygjin fetar.

Libri

Në mes titujsh librash kam mbet i **ngojuar** filloj
ti shfletoj por unë nuk i dua e ato më thojnë
mos më le mua.
Kam rënë në hallë edhe në dilemë se vite me
radhë ato më përcjellin.
Më janë futur në zemër se **mendja** më thotë se
ato nuk dalin sot e as një mot.
Të japin shumë vrull edhe energji që vite me
radhë të jetosh i ri.
Po filloj me të bukrën histori që më ngjallë
shpresat e të bukurës rini.
O libër i artë je shumë i zjarrtë je shumë **magjik**
edhe shumë besnik.
Ai që sta din vlerën nuk të mbetët **mik**.

Injoranti

Ç'na ke hipur mbi atë mur, e je kërrusur si ari.
I ke **zgurdulluar** sytë e shikon me ironi.

Injoranti i pa shpirt godet zërin si bori na
tronditi neve të gjorëve duke na quajtur **skllav
të zi**.
Nuk ke faj se nuk kemi ku t'shkojmë a
durohesh mor i zi.
Injoranti i pa turp është i shkrirë në moral
shfrytëzon **kaheje** e më të ngatit turp i çoftë
këti të ziut.
E shef vetën si luan e bën llafe si **llafazan** e
thotë se është intelektual.
Zhduku në ferr mor i zi se s'të njeh kush për
njëri.
Herë me njërin herë me tjetrin nuk len njeri pa
e përqeshur .
I bart fjalët si postier e të nesërmen shpejt i sjell
lavdëron punën për mrekulli shi çfarë bëri ky
njëri.
E ky tjetri si daij vjen e qesh me ironi hajde
jepni punës me shpejtësi se ju **zuri terri zi**.
Mbushem fort me ironi se ku ta hodhi nuk e di e
mbaj fort në vetmi gjerë sa të plasi nuk e di
shpresoj fundi le ti vi.

E shoh atë

Jemi ulur ballë për ballë po shikohem me
vështërsi se është petku ynë
i zi që na ndan në mes në vetmi po i **frenoj**
ndjenjat e mia shumë e rëndë qenka vetmia.
Unë nga lart e ti nga poshtë po **luhatem** si në
litar vrullshëm gjuhem në dritare ta shikoj
petkun zanë male.
Je e hijshme e sinqertë zemër madhe sa një qiell
je e mbyllur e izoluar je e vrazhdë e shikuar
rënd kontaktet i pranon e pak shumë i lexon.
Egërsirat të kanë rrethuar e shumë pak hapsirë
të kanë lejuar shpresoj cakut t'ia godas edhe
jetën ta brohoras.
shpresoj vuajtjet ti kalosh e ëndërrimet ti
shpresosh e vullnetin ta përjetosh.

Çabrati

Mes kodrinash bukuroshe të thepisura sa më ska është **Çabrati** fshat i bukur lulëzim ka çdo shtëpi.
Varg prej fshatrave më i dalluar varg prej fshatëve më i harruar varg prej fshtëve më të qëndruar e prej fshatëve më të zgjuar.
Logoja jote shumë me vlerë e i pa prekur shumë për herë të përkulna si çdo herë sje i ndyrë e sje plot sherr.
Shumë i ngushtë me shtëpi e i aftë shumë me dituri.
Mbajnë inat shumë ironi pse s'është fshati si të tjerët të përbashkët në një shtëpi.
Unë ju them o ju të zi që me vete mbani histori e udhëhiqni fshatra tjera si një shtëpi fshati im o ju të zi është i ndarë në **gjeografi** s'kufizohet me as njëri nuk përkulet pranë askujt edhe pse e bëjnë me vuajt shumë në mësime është kufizuar edhe shumë i **diskriminuar** unë ju them që mbani përgjësi për çdo hap për çdo fëmij dua të largohem nga kjo ironi po zemra më thotë të mos ti lejë këta fëmi.

Vdekje e hershme

Të qava se të kisha para syve të mi që ishe bërë dru e nuk flisje të **qajtën** të gjithë edhe pse nuk na dëgjove vijuam për në varrin tënd ku të pa shpirtit ta kishin hapur e me padurim priteshin që të futeshin në të e di dikush qante nga frika

se një ditë edhe atë do ta **gjen vdekja** e dikush nga dashuria që kishte për ty.
Jeta për ty ishte një copë lecke që e përdore për një kohë të shkurtër e tu harxhua pa dëshirën tënde.
E di se ndoshta ke mbetur sy hapur nga **malli** e nga mërzia e dashuria për ne.
E di se ndoshta kam bërë gabim që nuk të kam ardhur që së paku ta shtrëngoj dorën e ti bisedonim ca biseda që së paku të më kishin mbetur si ngushlluse po tani po të më shkonte mendja se ti do të bënte një gjë të tillë do të kisha ardhur pa pushim e të kisha **ledhatuar** fort.
Vdekja jote ishte një tronditje e thellë shumë e ftohtë dhe e pret në ndërgjegje.
Po flasë edhe një herë për ata indiferentet që të hodhën balt mbi fytyrën tënde si të ishin të pa shpirt e për disa minuta më nuk të pashë.
Pashë vetëm baltë të përzierë e të bërë **troqke**.
Ndoshta nuk e meritova se ta barta trupin tënd pa jetë prej kantinave të dyerve tua ndoshta shpirti yt ka fluturuar mbi mua duke më parë si një tepricë e lodhur dhe i pa dashur.
Po mendoje se jam i penduar për ngjarje të pa zakontë që goditi kokën time të grisur e të boshatisur nga mendimet e egra e të thara në amshim.
Ndoshta shpirti yt është dikund lartë që ulërimat e goditën aq fort sa që vinte gjerë tek ne por ne nuk i dëgjojmë.
Ndoshta shpirti yt udhëton dikund i qetë e i begatuar me të gjitha të mirat.

E di se misioni yt është një mision i pa kthyeshëm dhe ashtu si është ashtu edhe le të mbetet.
Që enigmën të ketë kënaqësinë që secili ta përjetoj në të **andejshmen të egër** dhe të urryer nga secili.

ë

Hiperbolë reale

E di se ndoshta do të zbehesh nga fjalët e pa cipa që do ti **dëgjosh**.
Këto janë fjalë të ngurta nga ana ime që ndoshta nuk mund ti shprehi me gojë ndoshta nga dashuria e madhe dhe pasioni im.
Por të jesh e bindur se fiziku im nuk është fajtor dhe nuk ki për çfarë të **mllefosesh** në të duhesh të inatosesh në brendësin time që me ka futur në flakë e nga plagët që i marr mbes i shtrirë dhe i pa fjalë.
Mundohem të iku **skajeve** të rrugës e qosheve të shkollës por përsëri intuita më mban tek ti.

Ndoshta morali dhe bukuria ndikojnë që ti të shkëlqesh në zemrën time vetëm atëherë ndihem ca i qetësuar kur të komunikojë e kur ta shtrëngoj dorën.
E di se është vështirë të shkruash për një njeri që ngërthen në vete një begati e një rrugë me shumë të mira në **personalitetin** e saj ngërthehet një mençuri, dhe një pasion për jetën që çdo kush e ka vuajtje për arritje.

Ti je

Ç' je bërë kësulë e pa vlerë i përlyer shumë me baltë mbi lustrën tënde ngërthehet një pasqyrë reale që **labirintin** tënd nuk mundte njeri ta zbuloj ndoshta nga padituria dhe opsionet që i jep.
Ke mbetur aty në buzë të rrugës që **gërryhesh** e zhgërryhesh me veglat e tua të punës e kur ngre kokën sheh njerëz duke të shikuar me **ironi** e duke u larguar nga ti.
Fillosh ti dashurosh njerëzit por të **pa njerëzit** nuk dashurohen fillon të flasësh me ta nga padituria e tyre fillon humori ndaj teje dhe nga gërmadha e fizikut te ti je viktimë.
E di ndoshta ata mund të mburren nga muskujt e tyre të pa vlera që një ditë do të bëhen baltë.
Por ti je dhe nuk je si ta edhe pse je së bashku me ta.

Ndoshta dikush është lodhur aq fortë sa ngushëllimin e ti mund ta shpreh duke u fjalosur me ty por tek ti vërehet që në fytyrën tënde mbizotëron një **sinqeritet** edhe pse fytyra jote e pastër si loti tani është bërë e pistë jo nga marrëzit e tua por nga pluhuri dhe balta që ngrihet nga toka dhe të **godet** ty.
E di se je në një fushë gladiatorësh që të mbijetosh duhesh të luftosh e di se ndoshta kolegët e moshës suaj që sillen lartë e poshtë e gëlltitin tërë ditën fjalë të pa cipa dhe të brishta në mendim nuk e kanë përjetuar një gjë të tillë.
E di se ndoshta ato pak të holla që do ti marrësh do ti shpenzosh për ca **libra** që në të ardhmen mendoje të kesh një karier të ndritur.
E di se kantinat e punës që ti e bën ta gëlltitin diturin por vendosmëria për të ardhmen do të jetë kalendar historik për ty.

Rrugë pa kthim

Mes vegimit nga **pagjumësia** mes urrejtjes nga vetmia,mes vdekjes dhe mistikës rrugë e drejtë shumë pa lake po e njëjta si gjithësi gëlldet njerëz e shumë fëmijë.
Mund të jetë fshat i mallkuar edhe rrugë shumë e vetmuar nuk le vit fëmijë pa kërkuar shumë pa pritë shumë pa kujtuar ulërimë dhe **klithma** u dëgjua shkova shpejt për të shikuar shumë një barrë më ka rënduar **kocka të kafkës** të bëra në copë të përlyera e të gjakosura.
Mendoj rruga s'mund të jetë që fëmijën ta gëlltit.
Nëna të rri në stres që fëmiut ti vë kujdes.

Shpresa

Mendje holla sy **xhelozja** shumë e veshur e këmbë holla?

Portreti i saj si rreze mali shtati i saj si një zanë mali.
Rreze bankës është e para shumë e ndritur mendje madhja është e shkathët sy magji i bënë planet për mrekulli.
I bëj pyetje me shpejtësi e përgjigjet i kthen me lehtësi të ledhaton për mrekulli e nuk fletë për as njeri.
Floku i saj i nxirë si korbi, vetulla e saj si një fushkaj që zgjon ndjenja me të parë.
Është e pjekur me shumë se **vajzë** e në debate zë vend të parë.
Fjalët boshe nuk i dëgjon ecja e saj peshe të qon.
Librin nuk e lëshon prej dore e shumë vargje qet në fletore.
E ka shkrimin për mrekulli,edhe presjet i vë me shpejtësi.
Është si yll që ndriçon natën është si gjarpër që helmon dhiatën.
Fytyra e saj e joshitur, qepallat e saja të shndritura.
Nuk zë gojë pa e përmendur se ajo është për të çmendur.
Shpresa më shumë,shpresa me **idil** e me shumë kthesa.
Është bukur për mrekulli kur t i fliteshe për këtë njeri.

Shefi

Sdi si erdhi u bë shef kokë madhi sa një dem.
Kishte gishtat me flori që i rrinin për mrekulli **bylyzyku** plot me ar si tja veshe pelës në barë.
Flokët e tija si larushku qe si lau as dushku bënte llafe e hante qetë sikur të ishte mbret në këtë jetë.
E punëtorët shumë i donte sa që çdo mëngjes në veshë i këndonte sikur të ishte gjel i ngordhur.
Kishte grua dhe fëmijë që si shikonte dot me sy kishte grua për mrekulli shkonte me meshkuj pa mërzi vishej ngushtë për mrekulli e punëtorët e shihnin me shumë dashuri.
Shumë shitëset ai i donte sepse shumë kohë me to kalonte.
Po sa shkelte shefi brenda tërë punëtorët vraponin sikur ti hante **gremza**.
E hingëllima i shkonte në qiell sikur donte të piqte në hell.
E paranë shumë e donte sa për to edhe jetën e huazonte.

Sdi si erdhi për një mend e unë thashë sikur ti bëja fotografi e ta vendosja në sheshe të zi dhe atë ta mbulonim me krenari.

Vdekje ankthi

Si një ankth në mes të natës u shua jeta një ulerim zëri trishtues u dëgjua nga dritaret e vogla të çatisë një ulërimë fëmijësh një ankth që goditi kokën e secilit një **padrejtësi** dhe një zbehje në besim.
Një zhurmë shpirtërore që gërryente shpirtin e të bënte të zbrazët nga rruga e jetës.

Një frikë jete që **gllabëronte** mendimin e secilit.
Një nënshtrim total mbi atë që ndodhë dhe një mëshirë mbi atë që do të ndodhë.

Vinë dhe shkojnë

Si një leth harrese më vërdallën fjalët në kokë një përsëritje rrugësh në çdo ditë një përqafim durësh në çdo kohë e më asgjë më shumë.
Një kujtesë harrese një korrelacion mes meje dhe saj.

Një epsh zhurmues që gërryen brendësin.
Një kalërim mendimesh që më ndjekin pasi
që më qojnë **drejt labirinthit** .

Vdekje zhurmuese

Buzë një trualli të përzierë me krimba ankth
varresh tingëllim.
Vdekje për njërzimin rrëfim darkë për
krimbin o vdekje trishtuese o **varre** të
shkreta turrni mbi kufomën time si të ishte
darkë me plotë gabime.
Mos ndjeni mëshirë se unë nuk dëgjoj çdo
kapërtypje e **mishit** ju shtonë jetë.

Një lagështi e një moçal me baltë që
përshkon trupin është bukur se nuk ndjenë
gjë.

Çetësi Vdekjesh

Një qetësi **varresh** të gjithë të
groposur nuk dëgjohen thirrjet
që të vinë për të lozur prishjen e
qetësisë e prish veç shiu qe i
këput fletët nga lisi e i tundë
era zhurma u dëgjua siç ishte
një hije mes hënës se ndritur
të qarë nga pafundësia.
Ishte veç një lojë shumë
imagjinare që t 'ia prishesh
qetësin tërë atyre varreve.

Një mike

Rreth e për qark gjurmonte mbi
targat e një mike. I humbur
nga një kohë i **bezdisur** në
mendime e dinte se që
mendoja se kurrë gjë nuk i
thoja këmbët si statujë të drejta si
në pikturë sytë e fiksuar si
të ishin në statujë.
Flokët e një mike të mbushur
me **aromë** që vinin pas shpine
sikur një leth.

Akomodim

Akomodim nga ai për atë
pa u shterur asnjëherë
Epsh për shtrëngatën e
dashurisë të asaj ulje
pranë saj tagër absorbimi për të.
Tjerrje mendimesh
për të quar tek zgjidhja
por pa rezultate.
Pëshpëritje dashurie
hijezim për të kalurën e gjatë.
Mallkim për **ndalje** që
të marrësh veprim.
Fjali ndjenjash që kapërthurën
në kokat të atij dhe të saj por
vetëm që tregojnë mjegull zhurmuese.
Trazirë ndjenjash mbi korridorin
e gjatë që në fund shkëlqen
vetëm një dritë me pak shkëlqim
e **shpresë** që pritet të jep kuptim.

Arlinda

Emër fort i tingëllueshëm që
gjarpëron nga e kaluara
njohje shumë e shpejt që
tingëllon nga e ardhmja shpërthim
bisedash pranë korridorit
aromë e bukur dijenie pamje
e dukshme e shpirtërore shume
e bukur e **lidhatore**.
Zgjonte ndjenja për mësim e
gjëmonte pa pushim.
Pyetje bënte hiq pa rreshtuar
vetëm në mësim për tu gjetur.
Ecjet e saja për mrekulli si
ta bësh këtë njeri.
Zhurmonin katet nga
njerëzia që ta takojnë këtë tek hyrja.
Nuk kalonte dita pa e parë
se ajo është për tu qarë.
Nga buzëqeshjet e saj si
engjëll gjëmon **intuita** për të çmendur.

PËRSHPËRIS ME VETËN

E- Korrelacion dashurie

E-Korrelacion i ndjenjës

së freskët të dashurisë.
E-Aromë e hipnotizuar e zonës
së pashkelur të dashurisë.
E-Rreze që shndrit mbi
mëndafshin e errët të dashurisë,
E-Sezon e takimeve e të gjurmëve
të lëna pas nga ecjet e **vrazhda** të
dashurisë.
E-Golgote për njeriun e
humbur duke të ndjekur pas.
E- Energji e frazuar ku engjëjt
e natës vraponin e më
frymëzonin edhe natën.
E-Ecje pa zhurmë dhe pas
pak shpërthim vullkanesh.
E-Humus për aromën e
flokëve që e kujtoj si një leth.
E-Imagjinatë e kujtesës e
harmonizuar nga ndjenja e
brendshme **ikje .**
E-Ndjenjë e fortë mos
largimi përkushtim për arritje synimi .

Ata që nuk janë

Çetësi heshtjesh pranë
lisave të gjatë afërsi njëri ndaj
tjetrit por vetëm heshtje.
Kush janë vallë këta?
Po janë **varret** me plot

njerëz të groposur që deri
dje ishin miq e sot po të
flasësh për ta ndjen ankth kur
përmend emrat e tyre sa keq?
Dua të marr guximin të
shkoj e ti liroj nga prangat
shekullore nga prangat që ia
mohojnë e drejta e shprehjes
së lirë edhe pse qëndrojnë sa
afër njëri- tjetrit por përsëri
nuk flasin sa keq?
Të gjithë ne jemi nisur drejt
grigjave të drejta pa as edhe
një lak të vetëm as edhe një
shpresë që të jetë kthim mbrapa.
Çka mund të marrim me vete?
Mund të marrim me vete
vetëm mëndafshin e hollë e
të coptuar me gërshërë që në
brendësi të saj është vetëm **fiziku**
jonë i përbërë nga kockat dhe
muskujt që pas një kohe do mbetet
vetëm kallëpi i thatë..

Pranë kohës

Kaluan shpejt shumë vite
që u **ndamë** nga etja dhe
malli më su pamë .
Qëndrova në errësirë ku hija
jote më thërriste pa mëshirë .
Tingëllim e zërit tënd **drithërues**
që më pushon aq e freskët
në mendjen time.
Sa shpejt humbi e kaluara
në duart tona e ardhmja e
zymtuar nga fjalët e pa rreshtura
ashtu sikur shiu që vërdalliset nga
erërat e fuqishme e që **tmerrësisht**
hidhet në tokë.
Vitet e pa konkretizuara të baticave të
mëdha e shumë të thjeshta të dashurisë.

Sa keq?

Ç'rrënjose këtë shprehje
të **varguar** nga lotët e pikëllimit
e që ngushllehem me shprehjen sa keq?
Ti turpërove një **epsh** të
koordinuar e të përsosur
dashurie e absorbohesh
me shprehjen sa keq?
Sa është keq?
Aq e sa kapërthuret e skuqja
në fytyrë e grryset nga e keqja
e që fundos një **Ajsberg**.
Klauzul që humbë ndjenjën
e së mirës e që nxitë aftin e së keqes.

Ikje

Arsyetim i ikjes tënde
është **penda** ime e strupulltë
që as edhe një çast nuk do të
pushojë duke shkruar për
mendimet e brishura dhe të
pa fuqishme për marrjen e një ikje.
Ikje e brishtë e me plotë **gabime** e
valëzime të përmallshme e humus
mbi kohët e pa harruara ikje
edhe pranë fotografisë tënde
që me nostalgji mbaja pranë
murit tim të ngujuar përballë
meje dhe e mbushur përplot ledhatime.
Ikje edhe pranë kujtesës së ecjeve të tua
Në fund broshurë e **kalbur** e mendimit për
ty.

Portreti yt

Varur mbi murin e akullt
portretin tënde që dita ditës
fillon të pikojë e që mbledh
e bëj aromë të bukur dashurie.
I frazuar nga etja e madhe që të
kem pranë në mes të natës
vizitoj portretin tënd prej akulli.
Katandisur mbes nga aroma e
portretit tënd si aromë e
engjëjve të dashurisë.
Me kujdes **hipnotizohem** pranë
saj sa që çdo imtësi të fytyrës bëj
matjen me pëllëmbë të dorës.
Sa fortë zhurmohem tek **buzët**
e tua sa që mendoj që je aty
po ajo që të takoi çdo ditë.
Portreti yt valëzon mbi
horizontet e pa kufizuara të
mbushura përplot trillime të dashurisë.
Portreti yt ankth i pashmangshëm në mes
të
katër mureve që pres
ta **shuaj** etjen pranë saj.

Zala

Pasthirrmë që **tingëllon** bukur
emrin tendë krenari e familjes
që të kujton ty.
Zalë që frazon të ketë çupa ime
të nesërmen sa me mallëngjim do ta
çmoj emrin e saj.
Sa inatosem ku ndonjëri do ta
qortoj e sa me inat do t'ia
shpalos aktin tim të brendshëm.
Zalë e kaluara jote sa e lavdishme e
në një të ardhme me
plotë shpërthime si syth.
Sa harres që kanë njerëzit për ty e
unë me shumë nostalgji të mbaj në shpirt.
Arenë e hapjes së mendimeve
klasik për më **aventurë** në të ardhmen je.

Ulur pranë bankës së saj

Kalibër i egër kujtimesh më
kanë kaluar duke
kujtuar bankën e saj.
Kujtoj fantazinë e saj qe
ulur pranë **dritares** tek shtegtonte
mendime të bukura dashurie
pa e kuptuar as edhe një i vetëm .
Sa me padurim pritesha të
marrë ftesën e të ulesha pranë
saj ndonjëherë edhe i pa ftuar.
Prockë e vogël më ka mbetur
nga kujtimet e mëdha e
titanike të bankës së saj.
Pranë bankës së saj pikon
qumësht i stërzgjatur dashurie.
Vagon i zgjatur bisedash, por
pa konkretizime.
Socizion përplot muaj e me
pak shpresë bashkimi.
E gjithë kjo apsurbim i tretur
mbi hijen e harresës të bashkimit.

Lyra

Lyrë moj e bukura lyrë sa
tingëllim të kalitur lëshon
mbi dashurinë e humbur në
pyllin e fantazuar të **Virgjilit**.
Mëngjesi për ty **Lyrë** është
amshim për ata që të dëgjojnë
Mesdita për të është tufë
luanësh që të ndjekin pas.
Mbrëmja për ta është orvatja
e fundit për mbijetesë.
Lyrë me zërin tënd **dridherak**
dëgjohesh matanë kodrave të
largëta bashkohesh edhe me
erërat që të sjellin pas e s'të
lënë të dëfrehesh aty ku je.

Pranë Korridorit

Hije e trazuar ankthi, kur pashë
portretin tënd vizatues sa i
çmendur u bëra ku pranë meje
nuk qëndrove as edhe një minutë.
I humbur rashë nga mjegulla
pabesie sa që për ngushëllim
biblioteka më ndihmoj.
I zhurmshëm u bëra nga teoritë
e thata duke zbehur kujtesën
për trillimet e çastit.
I harxhuar nga **momentet**
në çast krijoja koncepte të mirë largimi.

Faltore fati

Injorante i pastrupulltë
gënjeshtar korb i nxirë
brendësi mashtrues i çdo
njërit parashikues i mallkuar i fatit.
Kataruresh me copëza letra
që edhe unë isha viktimë sa
qesharak më bëri fakti tek sa
nise parashikimin tim.
Ti vjele të **holla** njerëzisë me
pisllëqet e tua aq sa je skeptik
sa që skuqësh nga padituria.
Shtjellove ngjarje të pa bëna
të krijuara nga **oratorit** boshe.
Je sofist i mallkuar që binde
njerëzit proletarë krijon imagjinata
të pa bëna gëzon mijëra zemra.
Shumë t'besojnë kjo njerëzia
sepse janë skeptik nga brendësia.
S'mundë të bëj ballë nga
ndodhia ti je ai që i drejton nga **fundërria**.

Ajo që më ndjek pas

Tentakul e pa **zgjidhur** që
më ndjek pas e varur në mua e
që nuk tregon se kur është vdekja.
Mister i brendësisë time që
nuk e shohë as edhe një çast.
Nuk dua të më ndjek pas
ajo që është në mua ajo është
ankth trishtim dhe e **mërzitshëm**.
Ah! sikur ta largoj nga vetja
nuk do të ndaloj as edhe një
çast vagonin tim për të jetuar.
Miku më i mirë i jetës
time dhe i pa ndashëm vdekja.
Ndonjëherë sillem me
mendimet e mia të egra e të pa
konceptuara se mik është edhe
njeriu a po të ishte kështu do
të jetoja pa brenga dhe pa llafe
po të gjithë miqtë as unë nuk
shkoj tek ta e as ata nuk do vinë
me mua në frymën e
jetës së fundit se **Holokaust** i
kundërthënieve është njerëzia.

Mëkat

Do të copëtohesh në copa
të imta si të atomit e do
të **digjesh** në flakën përvëlues të ferrit.
Do të shantazhohesh mbi
fatalet përbuzëse e mbi çatinë
e tymosur do të jesh e nxirë
ashtu siç më ke nxirë brendësin
time nga utopia jote në dashuri.
Je ndryshuar nga vitet që dikur
frymëzohesh me ligjet e ngurta e
me **kënde** të mbushura
përplot llavë e zjarr.
Sa keq që më dhe vetëm
një cep të vogël dashurie
e humbë pa gjurmë në lumin e harresës.
Nga të gjithë këto trillime
mua më bëre poet që çdoherë
sa kujtoj pamratdsin tuaj e për
hirë të dashurisë filloj të degdisi
vargje të bukura poezie.
Sa pa mall do ta shikoj **fytyrën**
tënde të groposur me plotë
hidhërime e të përbuzura
nga etja juaj në pikëllim.

Mos më pyetni

O njerëzit e mi që unë
sillem rreth jush e që sy hapur
jeni drejtuar drejt meje e do
më pyesni se çfarë për t'ju kthyer
përgjigjen ju kisha ftuar që të futuni
në **lëkurën** time e më së
mirë do ta kuptoni uraganin
e ngrirë nga acari e të boshatisur
në rrugën e largët të **amshimit**.
Si do të përgjigjem mikeve
të mia që besonin me mendje
dhe shpirt në një aspekt pozitiv
do ti them se jeni **përgjithmonë**
mike të mia e as edhe një çast nuk
dua të heq dorë nga nostalgjia.
Do ta shuaj **spiraitetin** tim se aq
shumë e kisha thelluar drejt saj
saqë ngjasonte me rrathët e

ferrit të **Dantes.**

Më jep një qetësi

Më duhet vetëm një çip
i **mbushur** përplot fjalë madje
fjalë bindëse ku çdo njeri do të
kishte pasion që ti dëgjoi.
Mos prish qetësin e pa fund të
shpirtit tim mos ik pranë dikujt
tjetër mos u bëj garë maratonike
frymëzohu që të më bëjshë një qetësi.
Nuk tallem nuk **frazohem** që të kem
fytyrën e njollosur madje as
edhe nuk shtirem për të
vetmen dashuri.
Do jesh e mbushur me mirësi nga
horizontet e mia do të vendos në
pikët më të larta të primatit do ruaj
me **nostalgji** tërë qenien tënde të
mbushur me brendësi dhe
te përbër nga kockat, muskujt dhe gjaku.
Mendoj se **këmbana** do të
tingëllon aq fuqishëm sa do
të dëgjoje e do të kthehesh
pranë qetësisë time.
Kam shpresë mendje dhe zemër

se do të jesh pranë hapësirës time
të mbushur përplot **vegime** për ty.

Pranë Fakultetit

Bushtër brendësi e pa cipë
honorar i pa caktuar dije.
Kalibër i ndryshkur i len
me mijëra vite në shi.
Objekt i çmuar **pisllëqe** që
mbanë në të .
Vagon i pa shkëputur elitash
përçarje e të mbushur përplotë
diskriminime padrejtësi totale që
çmohet ai me **plotë gabime**.
Nënçmim i dijes në objektin
tim klauzulë që i referohet padrejtësisë.
Profesor me plotë vlerë e stupstanca
Profesor me plotë turpëri
që vetëm heshtja i mban në brendësi.
Ligjërata te mbushura me
gojëdhëna e mitologji fantastike.
Koktell pranë ligjëratës
time **kukull profesoresha** ime horizont
i shkëputur dijenie.
Pazarllëqe që bën me numra e që
mbush fletat me to panoramë e
kujtimeve të vrazhda
lëngim i zonës së dijës.

I çmuar studenti i mbushur me
kopjime të zhytura me laps të zi
duartë si një tatua qe mbanë aty.

Hasit tim

Rreshtuar nga shumë **fshatrash**
je ti admirues për çdo të huaj
që të vizitoj ty as edhe njëherë nuk u
theve nga ligështitë.
Has trevë e shkelur e imja je ti sa
kusar e injorant tu vërsulen ty sa
butësisht e sa me dituri
largove nga vetja ti.
Sa shumë që më **mungon** vendi im
me fizikë e me tërë çenjen jam
strehuar tek ti sa më mungojnë
njerëzit aty sa pa mall
kujtoj largimin nga ju.
O vargmale e ju burime të kulluara
o pyje te gjata e të zbukuruar o ju
perëndi që dëfrehuni atje trevë e pa
harruar hasi im je ti me mijëra ftesa
do të bëj për ty që njerëzia të vijë aty.
Aq shumë të njoh në **pëllëmbë**

të dorës e për çdo fshat di histori.
Sa me mall do lidhja pranë ti e sa
me dashuri do te merrja **vash** aty.

Fshati saj

Jo edhe larg shumë për të
arritur aty mes të parit fshat
është i dyti pas tij shpesh kaloj
pranë tij e mbushem
përplotë me **nostalgji**.
Me shumë kujdes i përkëdheli
andej rrotull fëmijët ngase
ata ja të fshatit të saj mes
tjerash edhe shpërndaj ca
karramelka të ëmbla po sikur ajo.
Fshati i saj është si qyteti
Trojan por jo i rrethuar me mure

por me pyje të larta e cicërima të
ëmbla të zogjëve e që mendon
se ke hyrë në derën e parajsës.
Fshati i saj është **pikëtakimi** i të
dashuroreve.

Poezitë e tua

Poezitë e tua janë sikur ato
laviret që sillen lartë e poshtë
e nuk tregojnë se ku është caku.
Po pikërisht si një lavire e
rrugëve e që çdo kush ndalon
të flasë me të e që pas pak
mund të bëjnë për vete.
Poezitë e tua janë **metafora**
që tregojnë vetëm gjëra të pa
bëna gjëra që nuk përputhen me atë që dua.
Poezitë e tua nuk janë gjë tjetër
vetëm një fotografi **pornografike**
një fotografi që shikojnë vetëm
ata që janë të dashuruar marrëzisht
e që çmenden pas të dashurës.
Poezitë e tua i dua vetëm atëherë
kur shkruan për mua për fundërrinat

e mia në dashuri që s'mund do ti
realizoja e nga ato shkrimet e tua
për **mua** le të qeshin që të gjithë e
të më quajnë një **gomarec** i rrugëve
që shkon për të pirë ujë e nuk i japin.

Kukull profesoresha ime

Kam një kukull në kuti
që **përngjan** në të për mrekulli
ndjek udhëzimet si ti thonë
ashtu është profesoresha jonë.
Me të hyrë në fakultet
është e skuqur e bërë ibret.
Çfarë marrëzie ja bëjnë asaj
sa edhe **klasë** nuk i lëjnë aq shumë
zihet nga brendësia
pse ska klasë ajo e zia.
Tingëllim nga **taket** e saj e
që sillet pranë korridorit si
një bushtër logjik peshku
që nuk zë vende pa hequr.
Me t filluar ligjërata aq e
shumë skuqet e humb
kontrollin sa thua do të
bjerë andej rrotull.

Kush e solli si na erdhi nga
na **piku** si na doli që s njeh dije si maçoku.
Po t'ia bësh asaj një pyetje
zëri saj ngritët aq
lartë si të ishte **njeri pylli**.

Pranë Monitorit

Teknologji e çmendur
e zhvilluar kënaqësi tek sa rrija
aty pa pritur as edhe një çast
një e dridhur ne inbox **komentim**
që nuk më pëlqen fare e që prish
një **shtojzovalle** nga dashuria ime reale.
Sa të thëna krye këput sa të
kërkuara nga unë përgjigje çfarë
specie jo reale që nuk të ofron
bisedë as 5 minuta si të mos
humbësh nga mërzia si të mos
çmendesh nga pabesushmëria
por është kjo **dashuria**.
Monitori ankth për mua e tragjedi

pa kujtua si i tha ajo ato fjalë si pat
shpirt e zemër të gjallë që të më len si
kukuvajkë tërë natën sy haptë.
Se kupton çfarë vështërsie që
kam për të më shumë se hije.
Po në gjettë ajo më mirë nuk e
lidh kush me **zinxhir**.

Vetëlëndim

Nuk të thash gjë i ngrati pse bën hape ti të shpejt flet e flet për atë bisedë e në fund ti nuk më thërret.
S jam pa shpirt që të lëndoj **ty** mu thaftë ky emër.
Ti e ndjek aq e shumë bisedën sa që në fund flet për **diçka** tjetër.
Vetëlëndohesh pa dyshim që të them bisedën time aq e kam ikur nga biseda e kam shkuar drejt në mur aq **goditje** marr nga muri mbes i shtrirë aty mbi dhe.
Më kupto mori e gjorë mos prit me të **pikturua** në dorë mos u bëj e pa matur që të shëtitësh nga një e **paditur**.

Pres takimin

Kam harruar nga librat e pa fund e plotë
enigma që ta shoh edhe njëherë fytyrën
tënde që pres **takim** nga ti.
Poezinë po e shkruaj aty nga mesnata jo
edhe shumë larg dita e nesërme.
Në vagonin tim të brendshëm përcjelli
ndjenjë **skeptike** e shumë të padukshme.
Jam nisur që ti tregoj që të gjitha duke
filluar nga e para e duke përfunduar në
amshim.
Sa e pa besë është dashuria është si ata lotët
e bishës se ferrit që qanë me **6 sy** e që nuk i
shifen lotët.
Është por sikur ato **opingat** që po ti lësh në
ndonjë ngricë të madhe më nuk mund ti
mbathesh.
A sa janë të çmendur ata që dashurojnë
marrëzisht ngase ata nuk njohin dritën e
arsyes.
Janë të harruar nga të gjithë madje as pas
derës se ferrit të **Dantes** nuk i mbetet vend.

Dua të fle në gjum

